



# FTESË PËR KUOTIM CMIMI

*Shërbim*

*Procedurë për kuotim çmimi*

*Në përputhje me Nenin 9 të Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës  
(Shtator 2021)*

Data: 19.06.2024

Nr. i Prokurimit: BQK 24 036 234

## I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

## II LËNDA E KONTRATËS

### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: Shërbime të vazhdimit të licencave njëvjeçare MDM dhe ATP
Lloji i prokurimit: Shërbim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): n/a
Variantet pranohen: n/a
Vlera e parashikuar e kontratës: 13,000.00
Ndarja në Pjesë: JO

### III INFORMACIONE PËR SHERBIMET

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale shërbimet për vazhdimin e licencave njëvjeçare MDM dhe ATP, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t’u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

### IV KRITERET E PËRZGJEDHJES<sup>1</sup>/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t’i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<p><b>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 në rast se aplikohet)) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</b></p>	<p><b><u>Kërkesa 1:</u></b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p><b><u>Evidenca 1:</u></b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.</p>
	<p><b><u>Kërkesa 2:</u></b> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”</p> <p><b><u>Evidenca 2:</u></b> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.</p>
	<p><b>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara më lartë.</b></p>
	<p><b><u>Kërkesa 3:</u></b> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p> <p><b><u>Evidenca 3:</u></b> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i ofertuesve, nga grupi kërkohet që së bashku me tenderin të dorëzojnë edhe marrëveshjen e nënshkruar në origjinal për krijimin e grupit. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm para ofertuesit për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i ipet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Në marrëveshjen e grupit kërkohet të specifikohet lideri i grupit.</p>
<p><b><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të</i></b></p>	<p><b><u>Kërkesa 4:</u></b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p>

<sup>1</sup> Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

<p><i>dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><b>Evidenca 4:</b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><b>Kërkesa 5:</b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b>Evidenca 5:</b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><b>Kërkesa 6:</b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><b>Evidenca 6:</b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Nuk aplikohen</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – <b>Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 7 dhe 8) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</b></p>	<p><b>Kërkesa 7:</b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të natyrës së ngjashme gjatë 3 (tri) viteve të fundit</p> <p><b>Evidenca 7:</b> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi: a) certifikatat përkatëse ose referencat që evidentojnë realizimin e shërbimit të tillë dhe b) kopjet e kontratave përkatëse.</p> <p>Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><b>Kërkesa 8.</b> Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><b>Evidenca 8.</b> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me shërbimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë edhe 2024 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë) duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve.</p>
<p>Inspektimi i kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale</p>	<p>Banka Qendrore, me shpenzimet e saj, mund të kryejë një inspektim të operatorëve ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapaciteteve disponuese të tyre për vërtetimin e cilësisë, punën e tyre në vend sipas referencave, mjetet për transport dhe çdo informatë tjetër të nevojshme që mund të dëshmojë që ofertuesi mund ta realizojë kontratën.</p>

## V PROCEDURA

### V.1 Lloji i procedurës: Kuotim Cmimi

**VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të lirë”**

**VII INFORMATA ADMINISTRATIVE**

Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit : afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit 25.06.2024, ora 14:00 në e-mail adresën <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 25.06.2024, ora 14:00
Dokumentet me pagesë: Jo
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): n/a
Kushti i sigurimi të kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 60 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: 27.06.2024, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.

**VIII. ANKESAT**

Në përputhje me “Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)”, respektivisht sipas Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a> , brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.

**IX. ADRESA**

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni I Prokurimeve	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763